



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-115
Prishtinë, më 27 korrik 2010, në orën 9:50
Kabineti i Kryetarit

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 27 KORRIK 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Nexhat Daci, Naim Maloku, Ibrahim Gashi, Slllobodan Petroviq dhe Etem Arifi, anëtarë të Kryesisë;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Skënder Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Daut Beqiri dhe Sali Rexhepi.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë

R e n d i t e

1. Njoftimi me vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës lidhur me kthim në rishqyrtim në Kuvend të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës,
2. Propozimi i Bordit drejtues të BQK-së për shkarkimin e Guvernatorit të BQK-së dhe emërimin e ushtruesit të detyrës së Guvernatorit të BQK-së.

- 1. Njoftimi me vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës lidhur me kthim në rishqyrtim në Kuvend Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës**

Kryesia, pasi u njoftua me vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës lidhur me kthim në rishqyrtim të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, vendosi që atë ta procedojë për shqyrtim në mbledhjen e sotme plenare, më 27.07.2010.

- 2. Propozimi i Bordit drejtues të BQK-së për shkarkimin e Guvernatorit të BQK-së dhe emërimin e ushtruesit të detyrës së Guvernatorit të BQK-së**

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimin e Bordit drejtues të BQK, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë propozimin e Bordit Drejtues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës lidhur me shkarkimin e Guvernatorit të BQK-së, dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 10:00 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Divizioni për çështje plenare dhe procedurale.